



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:018943
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05374295

A.nr.230/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditësit Z. L. nga fshati K., komuna e V., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh. P., avokat nga Gj. me adresë në rrugën “Sh.”, nr., kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, për shkak të anulimit të vendimit, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 07.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit Z. L. nga fshati K., komuna e V., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh. P. avokat nga Gj., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi Nr.03/3737/20 i datës 05.01.2021 i Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt në pajtim me nenin 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 02.02.2021, ka kërkuar aprovimin e padisë së paditësit si të bazuar dhe anulimin e aktvendimit nr.1104/2017 të datës 11.12.2017 të Zyrës Komunale Kadastrale Viti, Aktvendimit nr. i lëndës/protokolit 1104/2017-a të datës 17.01.2019 si dhe aktvendimit nr. 03/3737/20 të datës 05.01.2021 të Agjencisë Kadastrale të Kosovës si të kundërligjshme dhe të pabaza dhe çështja t’i kthehet në rivendosje organit të shkallës së parë dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia kompenzoj shpenzimet e procedurës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit deklaroi: “Është fakt se paditësi ka pasur një autorizim që ta përfaqësoi bashkëshorten e tij M. L. për disa konteste e cila i ka pasur për biznesin saj, por një borxh të cilin e ka pasur të pa përmbushur, me një vendim të S. A. Përmbarues, i cili ka lëshuar një vendim për përmbarim për borxhin të cilin e ka pasur bashkëshortja e paditësit dhe këtu qëndron problemi. Shërbimi i kadastrit në Viti, tërë pasurinë e paditësit e regjistron në emër të Ndërmarrjes Goranoviç në Nikshiç . Kërkoj nga gjykata të

anulohet vendimi i AKK-së, sepse nuk ka pasur të drejtë që pasurinë e paditësit ta regjistroi në emër të Goranoviçëve nga Nikshiçi sepse kjo pasuri është e paditësit dhe vlen me miliona euro”.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: “Propozoj që padia dhe kërkesëpafia e paditësit të aprovet në tërësi si e bazuar dhe të anulohen vendimet e AKK-së, me të cilat janë vërtetuar dy aktvendime të kadastrit në Viti”.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 15.12.2023 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke i propozuar gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet padia e paditësit si e pabazuar dhe vërtetohet aktvendimi i të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: Aktvendimi për shënim të përmbarimit me numër të lëndës 1104/2017 dt.11.12.2017, urdhri për shënim të përmbarimit nën shenjen P.nr.427/17 dt.06.12.2017, propozimi për përmbarim 24.10.2017, urdhëri përmbarimor dt.24.10.2017, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan PPP.nr.40/17 dt.19.06.2019, kërkesa për rishqyrtim të aktvendimit për shënim të përmbarimit sdt.05.03.2018, njoftimi i dt. 17.11.2018, aktvendimi i Komunës së Vitisë 17.01.2018, ankesa e dt.21.02.2019, urgjenca e dt.12.11.2020, përgjigje në kërkesë dt. 23.10.2018, përgjigje në urgjencë dt. 24.11.2020, vendimi i të paditurës nr.03/3737/20 dt.05.01.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpafia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata gjeti se Vendimi i kontestuar nga ana e të paditurës është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Gjykata gjeti se e paditura ka marrë vendim në përputhje me ankesën e paditësit dhe vendimi i shkallës së dytë i Agjencise Kadastrale të Kosovës përmban dhe përmbushë të gjitha kushtet dhe elementet ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se paditësi as me padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për ti mbështetur pohimet e tij të cilat do të dëshmonin se me vendimin kontestues të të paditurës është shkelur ndonjë dispozitë ligjore në dëm të paditësit.

Gjykata konstatoi se vendimi i goditur me padi është i qartë si në pjesën hyrëse, ashtu edhe në dispozitivin e tij, arsyetimin si dhe Këshillën Juridike.

Gjykata i mbështeti si plotësisht të drejta dhe të ligjshme arsyet mbi bazën e të cilave është marrë aktvendimi i kundërshtuar dhe në këtë drejtim përkrahi arsyetimin e të paditurës të dhënë në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar se e paditura me të drejtë ka lënë në fuqi Vendimin e organit të shkallës së parë 1104/2017 të datës 17.01.2019, vendim ky i cili ka lënë në fuqi vendimin me numër 1104/2017 të datës 11.12.2017 i cili është marrë sipas Urdhrit për Përmbarim P.nr.427/2017 i datës 06.12.2017 në pronat e paluajtshme ZK Viti Binqë dhe Kabash e të gjitha këto të evidentuara në emër të Z. Ll. nga K. KK Viti.

Në lidhje me këtë gjykata gjeti se si organi i paditur, ashtu edhe organi i shkallës së parë, përkatësisht Zyra Kadastre në Viti, në rastin konkret kanë qenë të detyruara të zbatojnë shënimet

relevante për përmbarrim në përputhje me Urdhërin për Përmbarrim P.nr.427/2017 të datës 06.12.2017. Në këtë kuptim, gjykata vëren se në pikën I të dispozitivit të Urdhërit për Shënimin e Përmbarrimit, bëhet e qartë se Urdhëri për Përmbarrim caktohet në pronat të cilat janë në pronësi të debitorit Z..Ll., respektivisht të paditësit në këtë konflikt administrativ. Thënë këtë, është e qartë se Zyra Kadastrale në Viti me të drejtë ka zbatuar një Urdhër Përmbarrimor të marrë nga një Përmbarrues i licensuar dhe me të drejtë ka vendosur të dhënat për këtë urdhër në shënimet kadastrale të paditësit.

Gjykata gjeti se nuk është në kompetencë as të organit administrativ të shkallës së parë dhe as të organit administrativ të shkallës së dytë, që të marr vendime unilaterale apo të njëanshme për të fshirë në shënimet kadastrale informatat rreth përmbarrimit, përveç në raste kur pala paditëse apo organi tjetër, përkatësisht Përmbarruesi, i ofron dëshmi të mjaftueshme, të besueshme e të ligjshme të cilat dëshmojnë një situatë tjetër juridike nga ajo e konstatuar përmes Urdhërit Përmbarrimor. Nisur nga kjo, gjykata nuk gjeti që paditësi të ketë siguruar dëshmi që procedura përmbarrimore në rastin konkret, të ketë marrë epilog përfundimtar, në mënyrë që të ketë mundësi pastaj që këto dëshmi t'ia paraqes organit administrativ të shkallës së parë, përkatësisht Zyrës Kadastrale në Viti.

Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njejtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njejtat nuk i kanë provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj gjykata vlerësoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditëit. Mbi këto arsye thëniet e paditësve në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.230/2021, datë: 07.02.2024

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.